

**Akti i Themelimit
i Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar
“SunXpower”**

Themeluesit me poshte:

- “EuroElektra” sh.p.k., shoqeri me seli ne Tirane, paisur me NIPT L01808013Q, perfaqesuar nga administratori z. Elton Çekrezi. Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “Euroelektra” ne vijim do te quhet “Ortak”

Sot me date 19/02/2025, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin nr 9901, date 14/04/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themelojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar:

“SunXpower” sh.p.k.
ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

Objekti, emertimi, selia, regjimi juridik

Neni 1. Objekti i shoqerise

1.1 Shoqeria ka kete objekt veprimtarie:

Shoqëria SunXpower ka për objekt zhvillimin, financimin, projektimin, ndërtimin, perimin dhe mirëmbajtjen e impianteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, përfshirë energjinë fotovoltaike, energjinë e erës, hidrocentralet, biomasën, hidrogjenin e gjelbër dhe teknologjitë inovative për ruajtjen dhe optimizimin e energjisë. Shoqëria do të merret me importin, eksportin, tregtimin dhe instalimin e pajisjeve dhe teknologjive të avancuara në sektorin e energjisë, duke përfshirë panele fotovoltaike, inverterë, bateri, sisteme të menaxhimit të energjisë dhe pajisje të rrjetit inteligjent.

Shoqëria do të kryejë tregtimin dhe shitjen e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë pjesëmarrjen aktive në bursat energjetike si ALPEX dhe bursa të tjera rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe përmes marrëveshjeve bilaterale të tregtimit të energjisë. Shoqëria do të ofrojë shërbime për optimizimin e konsumit të energjisë dhe shpërndarjes inteligjente, duke implementuar modele të tregtimit peer-to-peer, platforma dixhitale dhe inteligjencë artificiale për menaxhimin e rrjeteve energjetike dhe shpërndarjen e balancuar të energjisë.

Shoqëria do të angazhohet në krijimin dhe menaxhimin e komuniteteve të energjisë, duke mundësuar prodhimin, vetëkonsumimin dhe shkëmbimin e energjisë ndërmjet konsumatorëve të lidhur, në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian për integrimin e burimeve të rinovueshme në sistemet energjetike të decentralizuara. Shoqëria do të ofrojë shërbime konsulence strategjike dhe financiare për investitorët në sektorin e energjisë, përfshirë hartimin e studimeve të fizibilitetit, analizave teknike dhe financiare, si dhe aplikimin për financime dhe grante nga fondet e BE-së dhe organizata ndërkombëtare.

Në kuadër të operacioneve të saj, Shoqëria do të marrë të gjitha lejet, licencat dhe autorizimet përkatëse nga institucionet përgjegjëse për zhvillimin e impianteve energjetike, si dhe do të sigurojë përputhjen me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare për energjinë e rinovueshme. Shoqëria do të angazhohet në certifikimin e projekteve të energjisë së gjelbër, tregtimin e garancive të origjinës dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e kompensimit të karbonit, në përputhje me standardet e qëndrueshmërisë dhe objektivat klimatike të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, Shoqëria do të ofrojë shërbime inxhinierike dhe teknike, përfshirë projektimin, instalimin,



mirëmbajtjen dhe supervizimin e impianteve të prodhimit të energjisë, auditimin energjetik dhe implementimin e zgjidhjeve për rritjen e efikasitetit energjetik. Shoqëria do të veprojë në përputhje me të gjitha rregulloret dhe ligjet në fuqi, duke bashkëpunuar me autoritetet rregullatore, operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, furnizuesit e energjisë dhe investorët për të zhvilluar projekte të qëndrueshme dhe të pavarura energjetike.

Në kuadër të zgjerimit dhe zhvillimit të saj, Shoqëria do të marrë pjesë në projekte të energjisë jashtë vendit, duke operuar në tregjet e liberalizuara të energjisë dhe duke ofruar shërbime të menaxhimit të projekteve, implementimit të teknologjive inovative dhe optimizimit të konsumit të energjisë për klientë industrialë, rezidencialë dhe sektorin publik.

1.2 Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivave të saj.

Neni 2. Emertimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

2.1 Ortaket vendosen që shoqëria të emërtojë

“SunXpower” sh.p.k.

2.2 Selia juridike e shoqërisë ndodhet në : Ambjent 20 m 2 në Imshtë Lushnje, zona kadastrale 1984; Numri i Pasurisë 192/

2.3 Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3 Regjimi Juridik

3.1 Shoqëria është, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

3.2 Me vendim të tyre Ortaket mund të ndryshojnë regjimin juridik të Shoqërisë n.q.s në të ardhmen krijohen premisa me të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Ortaket do të përshtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë dhe do të bëjnë regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.

3.3 Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në përputhje me ligjin.

3.4 Shoqëria do të ketë vullnet të saj.

Kreu II

Te Drejtat dhe Detyrat, Kohezigjajtja

Neni 4. Te drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut

4.1 Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruaj kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2 Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3 Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.4 Shoqëria përgjigjet ndaj të treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.

4.5 Ortaket kanë të drejtë të marrin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike etj.

4.6 Ortaket kanë të drejtë të bëjnë propozime, si dhe emerojnë e shkarkojnë administratorin ose administratorët, punonjësit, ekspertin kontabel apo likuidatorët.

Neni 5 Kohezigjajtja

5.1 Kohezigjajtja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar.



Kreu III

Kapitali themeltar, kuotat

Neni 6

6.1 Kapitali themeltar eshte 1,000,000 leke dhe eshte i ndare ne 1 kuotë.

6.2 Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte:

- “EuroElektra” sh.p.k., zoterues i nje kuote te shoqerise me vlere 1,000,000 leke me qe perben 100% te kapitalit te shoqerise.

Kreu IV

Organet e Shoqerise

Neni 7

7.1 Vendimet e Shoqerise merren nga Ortaket ne Asamblene e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori shoqerise dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar caktohen nga Ortaket e shoqerise.

Kreu V

Administrimi

Neni 8

8.1 Administrimi i shoqerise do te behet nga 1(nje) administrator

Ortaket emeruan administrator te shoqerise z. Elton Çekrezi.

8.2 Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte ripërteritje ne perfundim te mandatit.

Kreu VI

Dispozita te tjera

Neni 9

9.1 Fitimi i realizuar nga shoqeria mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do te mbetet ortakeve te shoqerise ne raport me zoterimin e kuotave te kapitalit.

9.2 Ky Akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“SunXpower” SH.P.K.

“EuroElektra” sh.p.k.

